

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kontroll agjencie funerale në Tiranë, masa për reklamat dhe ekspozimin në zonat e banuara
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/kontroll-agjencie-funerale-ne-tirane-masa-per-reklam-at-dhe-ekspozimin-n-i586884
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 12:57:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 13:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c7514dcf8ac53fc557d4890cb96c2586e269eb0bb16382196d89cd921f2b1d85
TEKSTI	015718aaf1a6d45f79bee77f929f8bc3bfc4339a02f604bb80792c7652a5c5f
PAMJA	ddd52acb498bb766028ea06ecfb8a54467cc3e9511c77216c5b9fe95e51aee78

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d63e40e41e1154277ccbeb870c9b961e3bb6559600fc35f9fa104cb583d1b23d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d63e40e41e1154277ccbeb870c9b961e3bb6559600fc35f9fa104cb583d1b23d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Yjet jashte dhe rikthimet e bujshme, Spanja dhe Anglia publikojne listen e lojtareve te thirrur per Ligen e KombeveHarry Kane dhe "Topi i Arte": S'me pelqen te flas per ve fundit

Kontroll agjencie funerale në Tiranë, masa për reklamat dhe ekspozimin në zonat e banuara



18 Shtator 2026, 15:50Sociale TEMA



Bashkia e Tiranës ka nisur kontrollat në terren ndaj agjencie funerale, pas ankesave të përsëritura të qytetarëve për mënyrën e reklamimit dhe ekspozimin e elementeve të lidhura me këtë aktivitet në zonat e banuara.

Prej afro një viti, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka marrë ankesa nga banorë që jetojnë pranë këtyre subjekteve. Reklamat në fasada, objektet e ekspozuara në ambientet e jashtme, si edhe automjetet e parkuara pranë agjencieve, kanë krijuar shqetësim në përditshmërinë e komunitetit.

Pas përfundimit të afatit gjashtëmujor që u ishte lënë subjekteve për të përshtatur aktivitetin me kërkesat e Bashkisë, inspektorët e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Policisë Bashkiake zhvilluan kontrolle të përbashkëta në disa zona të kryeqytetit.

Aksioni nisi në Njësinë Administrative nr. 5, një nga zonat më të populluara të Tiranës dhe ku, sipas Bashkisë, janë regjistruar edhe ankesa të vazhdueshme nga qytetarët.

“Është marrë një nismë, në zbatim edhe të vendimit nr. 44, për subjektet që ushtrojnë këtë lloj aktiviteti, në mënyrë që elementet e lidhura me të të mos ekspozohen në fasada dhe në vende të dukshme. Duke marrë shkas edhe nga ankesat e qytetarëve, grupet e Bashkisë dhe drejtoritë përkatëse kanë nisur sot kontrollat në Njësinë nr. 5, si një nga njësitë më të populluara. Këto kontrolle do të vijojnë edhe në njësitë e tjera. U bëjmë thirrje bizneseve të bashkëpunojnë dhe të respektojnë rregullat, në mënyrë që të shmangen shqetësimet për banorët,” u shpreh Besmir Nela, drejtor i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës.

Në mbështetje të kontrolleve në terren ishte edhe Policia Bashkiake, e cila do të asistojë strukturat e Bashkisë gjatë vijimit të aksionit.

Kontrollet do të vijojnë në të gjitha njësitë administrative të kryeqytetit, me synim disiplinimin e reklamimit dhe të ekspozimit të aktivitetit të agjencie funerale, veçanërisht në zonat e banuara.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Deputeti i PS, humb bashkëshorten: Mesazhi prekës i tij...](#)

14:19 Sociale

[FOTO/ Rama vizitë në Malin Athos, kalon natën në një nga manastiret më të njohura ortodokse](#)

20:57 Sociale / 32 komente

[Një gabim ortografik gazetaresk lë pa gjumë familjen e qytetarit Haskaj. Ankohet në AMA](#)

20:00 Sociale / 2 komente

Konferenca "Tirana Fire Safety 2026", Ministri Nufi: "Mbrojtja civile nuk mund të ndërtohet vetëm mbi reagimin, duhet parandalim"

14:10 Sociale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.